




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 09/94  
Datë: 19.03.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 mars 2019, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncepti Dokumenti për Kinematografinë.
2. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada – Government*

*Ministrie e Kulturës, Rinisë dhe Sportit*  
*Ministravo Kulturne, Omladina i Sporta – Ministry of Culture, Youth and Sport*

---

**KONCEPT-DOKUMENTI**  
**PËR KINEMATOGRAFINE E KOSOVES**

## Kapitulli 1: Hyrje

Krijimi dhe zhvillimi i politikave, ambientit dhe mekanizmave të promovimit e kulturës sikurse dhe avancimi i infrastrukturës kulturore me qëllim të krijimit të kushteve adekuata hapësinore, teknike dhe profesionale janë objektiva institucionale dhe njëherazi prioritetet afatmesme të parapara dhe në politikat programore si dhe në dokumentet relevante strategjike.

Lidhur me këtë, Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021, në funksion të përkrahjes dhe avancimit të sektorit kulturor, ka paraparë një mori masash e objektivash sikurse rishikimi përkatësisht avancimi i kornizës ligjore dhe hartimi i politikave të reja publike që garantojnë pavarësi financiare për institucionet e kulturës dhe menaxhim efikas të përgjegjësi; krijim të politikave të reja kulturore me programe në përkrahje të artistëve dhe nismave kulturore, ristrukturim dhe riorganizim të institucioneve vartëse për kulturë, promovim të kulturës dhe ngritjes së komunikimit kulturor; edukimit; aftësimit dhe pjesëmarrjes aktive në jetën kulturore.

Një prej çështjeve më të rëndësishme në këtë kuadër mbetet padyshim edhe mbështetja e institucioneve publike të kulturës e me theks të veçantë kapaciteteve njerëzore e institucionale që mbesin parakusht në avancimin e agjendës institucionale për zhvillimin e kulturës në përmbushjen e misionit dhe fushëveprimit të institucioneve kulturore.

Në këtë drejtim, Ministria e Kulturës, Rimisë dhe Sportit në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë tek objektivi *Përkrahja e krijimtariisë kulturore, ndër-kombëtarizmi i kulturës* dhe në nën-objektivin *Mbështetja e Institucioneve Publike të Kulturës* përkatësisht Lista e Koncept Dokumenteve për vitin 2018, e miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit bazuar në Rregulloren Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë se Kosovës ka paraparë hartimin e Koncept Dokumentit për Kinematografinë si një mundësi e adresimit të çështjeve të listuara përkatësisht definimit normativ e trajtim adekuat të tyre.

## Kapitulli 2: Përshkrimi dhe definimi i çështjes/problemit kryesor

### Shpjegim

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008 dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, shumica e ligjeve ekzistuese pësuan ndryshime substanciale bazuar në statusin e ri juridik, duke u munduar të harmonizojnë ligjet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dhe duke krijuar ligje të reja që ndihmuan në rregullimin e problemeve që preokupojnë qytetarët e RKS.

Çështja është se përkundër realitetit të ri, Qendra Kinematografike e Kosovës dhe Kosova Film ende vazhdojnë së funksionuari sipas Ligjit Nr. 2004/22 Për Kinematografinë, i aprovuar në Kuvendin e Kosovës në vitin 2004 sipas Kornizës Kushtetuese për Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/9).

Bazuar në këtë, është domosdoshmëri koherente plotësim ndryshimi i tij për ta harmonizuar me legjislacionin e ri të miratuar nga Kuvendi i Kosovës sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe për t'iu përgjigjur rrethanave të krijuara që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, me theks të veçantë dhe në harmonizim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Problemet e identifikuara gjatë zbatimit të ligjit tanimë në fuqi e të evidentuara nga institucionet zbatuese janë si në vijim: paqartësia dhe mungesa e përkufizimeve të reja, çështja e distribuimit të filmave, mungesa e precizimit normativ për çështjet e promovimit të industrisë filmike dhe të prezentimit ndërkombëtar, harmonizimi me legjislacionin e BE-se, sjellja në jetë e Fondit për Kinematografi etj.

Grupet të cilat janë të ndikuara drejtpërdrejtë nga Ligji për Kinematografinë janë shoqatat e film-bërësve dhe shoqatat e producentëve, po ashtu nga normimi jo i sakte në Ligj ndikohen edhe film-bërësit e huaj, të cilët për shkak të procedurave tejet të pakuptimta të lejeve që duhet marrë për të xhiruar në Kosovë, si për filma, dokumentare dhe për lloje të tjera të zhvillimit kinematografik hezitojnë të vijnë për të zhvilluar projektet e tyre.

Pasiqë bota kinematografike çdo ditë e më shumë është duke evoluar shprehet nevoja që në ligjin për Kinematografinë në Nenin 1 “Përkufizime” të përmirësohen disa përkufizime siç janë: film vendës, producent, si dhe të shtohen përkufizime të reja të nocioneve siç janë: Video games, TV drama, Virtual Reality, dhe njëkohësisht të rregullohen dhe të futen në ligjin për Kinematografinë këto opsione të cilat më parë kanë munguar.

Qendra Kinematografike e Kosovës është formuar dhe funksionon si institucion në varësi të MKRS, ku sipas Ligjit për Kinematografi KREUT III, neni 20, “Institucionet” paragrafi 20.1. “për realizimin e objektivave të politikës së zhvillimit të kinematografisë, për përmbushjen e përgjegjësisë dhe të kërkesave që pasqyrojnë interesin publik në këtë fushë, themelohet Qendra Kinematografike e Kosovës si institucion me atributet e autoritetit qendror për kinematografi, në varësi të Ministrisë së Kulturës”. Pas analizave, përvojave me shtetet e tjera dhe diskutimeve me profesionist të fushës kinematografike konsiderojmë se kjo çështje do të rregullohet me se miri nëse Qendra Kinematografike e Kosovës do të shndërrohet në Agjencion në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, praktike kjo edhe e vendeve të cilat kanë një zhvillim të hovshëm në fushën e Kinematografisë, me të cilin ndryshim do të formohet edhe Kodi buxhetor vetanak i QKK. Po ashtu nga neni 48, pika 48.1. në të cilin thuhet: “Me qëllim të krijimit të kushteve materiale për zhvillimin e veprimtarisë prodhuese dhe kinematografisë riprodhuese, në kuadër të Ministrisë së Kulturës, me kete ligj themelohet Fondi për Kinematografinë (“Fondi”)”. Fond ky i cili nuk është vënë në jete asnjëherë për shkak të kolizionit të ligjeve, e

qe ky fond the buxheti vetanak do te mundesonin kryerjen e punëve me efikasitet dhe me shume lehtësi, pra do te sillte lehtësira financiare.

Sipas Ligjit per Kinematografi, Neni 42 “Kuota e subvencionimit”, pika 42.2. QKK nuk financon ne lartësi me shume se 51% te shumes se përgjithshme te projektit filmik, standardet teknike, raportin e komisionit financiar dhe vlerësimin e jurisë per frytshmerine artistike, kulturore-sociale dhe ekonomike te projektit, e qe e njëjta sipas Rregullores Nr. 02/2013 per subvencionimin e projekteve filmike nga Qendra Kinematografike MKRS, neni 11 “Subvencionimi/Bashkefinansimi”, QKK financon 51% te vlerës se përgjithshme perveq per filmin vizatimor – te animuar dhe projektet e kineasteve te postdiplomuar/debutant. Kesisoji rregullimi normativ eshte i pakuptimte, pasi qe jashtë cdo praktike evropiane dhe nderkombetare nuk mund te jete vete shteti edhe subvencionues edhe producent i filmit, pra duhet te behet harmonizimi i ligjit kinematografik me ligjet e BE dhe ato nderkombetare, te cilat parashohin subvencionimin e filmave 70-90%. Po ashtu me ligjin aktual nuk parashihen shume forma te perkrahjes/subvencionimit, si ne vijim: nuk ekziston zhvillimi i skenarit; postproduksioni; mbeshtetja per distributor; shfaqes; per festivale; forma te reja te te berit film; Virtual Reality; video games; per Tv Drama; mungojne shume elemente te zbillimit te film-bejtes te cilat jane shfaqur viteve te fundit ne Evrope dhe me gjere, e te cilat shtojnë nevojën qe te futen dhe te rregullohen me Ligjin per Kinematografi.

Nje tjetër ndryshim i cili duhet te behet eshte edhe neni 43, paragrafi 43.6 “Juria Vleresuese perbehet nga 7 anetareve te cilët ne rradhet e veta zgjedhin me kosesus kryesuesin qe ne mbledhjen e pare, ndërsa ne mungese te konsensusit kryesuesin e cakton drejtori i QKK”. Ne baze te bashkëbisedimeve me komunitetin film-bërës dhe me shoqatat e ndryshme kemi ardhur ne përfundim qe numri prej 7 anetareve te Jurise Vleresuese eshte tejet i madh, sepse krijon kosto te larte financiare per Institucionin. Ashtu siç e parashohin edhe shume konkurse te vendit tone numri prej 3 anetareve te Jurise Vleresuese do te ishte ideal, ashtu siç edhe komuniteti film-bërës e arsyeton.

Ligji per kinematografinë, neni 6, pika 6.1 thote qe “Producenti i jashtëm mund te xhiroje nje vepër filmike ne Kosove nëse paraprakisht ka marre lejen e xhirimit nga QKK”, lidhur me piken 6.3 “Ministria e kultures miraton urdherese administrative per mënyrën dhe kushtet e dhënies se leje xhirimit”. Pra nje praktike e tille eshte tejet sanksionuese dhe kufizuese dhe kundër cdo rregulli te praktikave evropiane. Ndryshimi i këtij neni do te ishte tejet i rëndësishëm, ne menyre qe procedura te thjeshtëzohet ne ate pike qe film-beresit e huaj te mos hezitojnë qe te zhvillojnë xhirime per te gjitha kategoritë e filmit ne shtetin tone.

Neni 9, pika 9.1. “Per cdo film vendës apo te huaj qe synohet te shfaqet publikisht, para se te kete shfaqjen e pare ne Kosove, distributori, përkatësisht shfaqesi duhet te merr lejen per shfaqjen publike te filmit, lidhur me nenin 10, pika 10.1. Komisioni i Vizionimit te QKK jep leje per kategoritë e mëposhtme siq jane: Kategoria A- kur filmi lejohet per te gjitha moshat pa kufizim ne aspektin e kohës te projektimit publik; kategoria “B”- ku filmi lejohet per te gjithë banoret mbi 14 vjec dhe kategoria “C”- ku filmi lejohet per te gjithë banoret mbi 18 vjec. Kërkohej qe ky nen te largohet nga Ligji për Kinematografinë, dhe i njëjti te rregullohet me

akt nënljigjor, pasi që kategorizimi i filmave sipas praktikës evropiane dhe me gjere ndryshon pothuajse çdo pese vite, e qe me akt nënljigjor do te ishte shume me e lehte te ndryshohet kur te jete nevoja.

Nje tjetër prioritet i vlerës se veçante është edhe atributi i QKK, sipas Rregullores nr. 07/2016 për subvencionimin e projekteve filmike, neni 23: “Qendra Kinematografike e Kosovës ka atributin e bashkëproducentit dhe do të marrë pjesë në ndarjen përpjesimore të bashkëfitimit nga shfrytëzimi i veprës filmike”. Eshte jashtë çdo praktike evropiane dhe ndërkombëtare qe shteti te jete edhe producent edhe subvencionues, pra QKK duhet te jete vetëm subvencionues i filmit. Dhe ndarja perpjesimore e bashkëfitimit te filmave ne festivale te ndryshme nderkombetare nuk eshte bere asnjëherë, praktike kjo e cila do t'i sillte QKK rritje te fondit, e te cilat fonde do te përdoreshin per filma te rinj.

Me ligjin aktual parashihen edhe Inspektorët: sipas nenit 13 të ligjit per Kinematografi “përmbushjen e kushteve te parapara me nenin 12 siq jane rregullimi i hapsirave dhe krijimi i tyre per persona me aftësi te kufizuar, përcaktimi i vendit se ku do te behet shfaqja e filmave, përmbushja e kushteve te nevojshme, e mbikëqyrin inspektorët përkatës.” Me plotësim-ndryshimin e ligjit te ri kërkohet qe ky nicion te shuhet, pasiqe asnjëherë nuk eshte përmbushur nje kusht i tille.

Nje tjetër nevojë per ndryshim te ligjit eshte edhe misioni i Bordit, menyra e emerimit te Bordit, presim qe ndryshim plotësimi i Ligjit per Kinematografi te ofroje mundësinë qe Bordi te zgjidhet nga propozimet e shoqatave, me konkurse publike, dhe qe Bordi te jete bord këshillëdhënës/profesional dhe pa kompetenca ekzekutive.

Nevoja për krijimin e institucioneve te reja ne varësi te Minsitrise se Kultures, Rinise dhe Sportit si: themelimi i institucionit te ri te Kinemasë publike, sepse Kinemaja ABC është ndërmarrje publike nen kompetencat e AKP-se, shton nevojën e ndryshimit te ligjit. Mirëpo pasi qe krijimi i Institucioneve te reja ne kuadër te MKRS paraqet kosto te larte financiare, propozojmë qe Kinemaja publike te shërbeje si ndërmarrje publike ne kuadër dhe si departament i QKK-se. Po ashtu me ndryshim-plotësimin e ligjit synojmë bartjen e pronës se Kosova Film-it nga AKP ne Ministri te Kulturës, Rinise dhe Sportit, rregullimin e misionit dhe përgjegjësiwe te Kosova Film, e cila shton rëndësinë e ndryshim-plotësimit te ligjit aktual.

Me rendësi te veçantë është edhe çështja e distribucionit te filmave, ku me ligjin aktual nuk janë te rregulluara fare çështjet e distribuimit te filmave ne Kosove. Duke zhvilluar politika dhe mekanizma për mbështetjen e distributoreve do te inkurajohen kompani qe merren me distribuimin e filmave vendor, e qe distribuimi i filmave do te behej ne platformën online dhe përmes kinemave publike. Po ashtu shtrohet nevoja edhe për rregullimin normativ te ndarjes se çmimeve vjetore për Kinematografi, i cili aktivitet nuk përfshihet ne ligjin ekzistues. E qe ndryshim-plotësimi i ligjit aktual do te bënte te mundur themelimin e organizimit te çmimeve kombëtare te Kinematografisë, ku se bashku me Shqipërinë do te organizohej çdo dy vite ky event i “National Film Awards”, ku do te ndaheshin çmime kinematografike, e qe do te kishite kosto te lehte financiare.

Duke pas parasysh që legjislacioni për Kinematografinë është mjaft dinamik dhe paraqiten ndryshime të vazhdueshme, nga kjo ka rezultuar nevoja që të bëhen plotësime dhe ndryshime të Ligjit për Kinematografinë me qëllim të përcjelljes së legjislacionit të BE-së dhe atij ndërkombëtar.

### **Politika aktuale**

Në funksion të harmonizimit dhe përafrimit me praktikën, standardet dhe përvojat e shteteve evropiane në fushën e kulturës, është punuar dhe janë krijuar drafte me ekspert të Bashkimit Evropian, të paguara nga programi TALEX i BE-se. Mirëpo me ndërrimin e qeverise të gjitha përpjekjet dhe puna që është bere kane mbetur ne gjysme.

Misioni i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është hartimi dhe zbatimi i politikave zhvillimore sipas standardeve evropiane, duke e konsideruar kulturën si një mekanizëm me ndikim të fuqishëm për zhvillimin demokratik të vendit dhe për afirmimin e identitetit kulturor të Kosovës brenda identitetit kulturor evropian.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit gjatë periudhës 2015-2018 në fushën e kulturës ka vazhduar dhe synon të vazhdojë me përkrahjen e institucioneve vartëse të kulturës, përmes investimeve kapitale, plotësimit të infrastrukturës ligjore, subvencionimit të kulturës së pavarur, promovimit të skenës kulturore në ngjarjet e mëdha të kulturës në Evropë dhe botë.

Politikat aktuale të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit zhvillohen bazuar në kornizën aktuale ligjore.

Në fushën e kinematografisë është në fuqi Ligji Nr. 2004/22 për Kinematografinë i aprovuar në Kuvendin e Kosovës në vitin 2004 sipas Kornizës Kushtetuese për Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/9).

Me këtë Ligj rregullohen çështjet si në vijim:

- Përcaktohen normat themelore për ushtrimin dhe mbarëvajtjen e kinematografisë;
- Prodhimi, distribuimi dhe shfaqja publike e veprave filmike;
- Shpall konkurse dhe subvencionon projekte filmike;
- Misioni i Këshillit Drejtues;
- Autorizimet dhe përgjegjësitë e Qendrës Kinematografike të Kosovës; dhe
- Çështjet tjera të rëndësishme për veprimtarinë e Kinematografisë.

Mirëpo pavarësisht rregullit aktual normativ të botes kinematografike lind nevoja për ndryshim-plotësim të ligjit për Kinematografi sepse dinamika e zhvillimit të kësaj lëmie të rëndësishme ka bere qe edhe ne Listën e Koncept Dokumenteve për vitin 2018, te miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës se Kryeministrit bazuar ne Rregulloren Nr. 09/2011 te Punës se Qeverise se Kosovës te parashihet hartimi i Koncept Dokumentit për Kinematografinë si një mundësi e adresimit të çështjeve të listuara përkatësisht definimit normativ e trajtim adekuat të tyre.

## **Ligjet dhe aktet nënligjore**

### **Ligjet:**

Ligji Nr. 2004/22 për Kinematografinë i aprovuar në Kuvendin e Kosovës në vitin 2004 sipas Kornizës Kushtetuese për Institucionet e Përkohshme te Vetëqeverisjes në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/9).

### **Aktet nënligjore**

1. Statuti i Qendrës Kinematografike te Kosovës;
2. Rregullore Nr. 02/2013 për subvencionimin e projekteve filmike nga Qendra Kinematografike e Kosovës;
3. Rregullore Nr. 01/2013 për punën e jurisë vlerësuese për projektet filmike qe subvencionohen nga Qendra Kinematografike e Kosovës;
4. Rregullorja (MKRS) Nr.08/2016 për punën e jurisë vlerësuese për projektet filmike qe subvencionohen nga Qendra Kinematografike e Kosovës;
5. Rregullorja Nr. 04/2012 për ndarjen e çmimeve për kinematografi;
6. Rregullore Nr. 13/2016 –MKRS për punën e Këshillit Drejtues te Qendrës Kinematografike te Kosovës;
7. Rregullore për organizimin funksionimin e Kosova Filmit;

Në bazë të këtij ligji dhe akteve nënligjore janë konstituar dhe funksionalizuar institucionet si: Qendra Kinematografike e Kosovës dhe Kosova Filmi.



### **Programi aktual**

Programi aktual zhvillohet konform Planit Vjetor të Punës për vitin 2018, dokumenteve strategjike dhe politikave afatmesme të MKRS, në kuadër të cilave janë paraparë aktivitete që derivojnë nga Ligji aktual i Kinematografisë.

Në Planin e punës për vitin 2018 janë paraparë këto prioritetet kryesore:

- Përkrahja e zhvillimit të kulturës dhe krijimtarisë kulturore në Kosovë;
- Ndërkombëtarizimi i kulturës përmes pjesëmarrjes në evenimente ndërkombëtare;
- Bashkëpunimi ndërkombëtar i institucioneve kulturore;
- Avancimi i kornizës ligjore dhe formalizimi i bashkëpunimit kulturor me institucionet rajonale dhe ndërkombëtare në fushën e kulturës;
- Avancimi i veprimtarisë kulturore përmes mbështetjes së aktiviteteve kulturore dhe artistike.

Prioritet e lartpërmendura janë planifikuar të zbatohen përmes Planit Vjetor të Punës, në bashkëpunim dhe koordinim me Qendrën Kinematografike të Kosovës.

### **Shpenzimet aktuale**

Bazuar në politikat programore, MKRS/Departamenti i Kulturës bënë mbështetjen institucionale të kulturës.

Lidhur me këtë çdo vit planifikohen dhe ndahen mjete financiare, në kategorinë e subvencioneve si: projekte filmike dhe për funksionalizim të Qendrës Kinematografike të Kosovës. Për vitin 2018, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka ndare shumën prej 803,776.89 Euro për Qendrën Kinematografike të Kosovës.

<b>Qendra Kinematografike e Kosovës</b>					
Buxheti	Viti	Shuma	Viti	Shuma	Shuma
Pagat dhe mëditjet	2018	33,281.89 €	2019	33,281.89 €	33,281.89 €
Subvencione	2018	765,995.00 €	2019	765,995.00 €	765,995.00 €
Mallra dhe shërbime	2018	4,500.00€	2019	4,500.00€	4,500.00€

Komunali	2018	/	2019	/	2020	/
Investime kapitale	2018	/	2019	/	2020	/
<b>Buxheti total</b>	<b>2018</b>	<b>803,776.89€</b>	<b>2019</b>	<b>803,776.89€</b>	<b>2020</b>	<b>803,776.89€</b>

### Vlerësimi plotësues i politikës aktuale

Politika aktuale për mbështetjen institucionale të kulturës është hartuar dhe zbatuar nga ana e MKRS-së bazuar në ligjin aktual të Kinematografi-së.

Në politikën aktuale zë vend të rëndësishëm edhe bashkëpunimi ndërkombëtar i QKK-së që ka realizuar me institucionet kulturore në rajon dhe vendet tjera të BE-së, e cila po vazhdon edhe ne ditët e sotme dhe do te vazhdoje edhe me tufje, duke nënshkruar marrëveshje me shtetet e rajonit dhe me gjere.

Duhet cekur se ligji aktual i QKK-së, mbi bazën e të cilit është hartuar edhe politika aktuale në fushën filmike, sa më shpejtë duhet ndryshuar me qëllim të harmonizimit me legjisllacionin e ri të aprovuar në Kuvendin e Kosovës dhe harmonizimit me legjisllacionin e BE-së.

Plotësim ndryshimi i ligjit aktual do të sjellë ndryshime të rëndësishme pozitive në politikat aktuale dhe në funksionalizimin e institucionit, si dhe puna mes QKK-se dhe shoqatave filmike dhe te ngjashme do te jete me efikase.

Gjithashtu ky plotësim/ndryshim i ligjit do të mundësonte plotësimin e politikës aktuale, do te përmbushte zbrazëirat normative, do te mundësonte lehtësirat financiare, do te krijoheshin te hyra financiare, do te mundësoheshin investime kapitale si ndërtimi i kinemave, ndryshimi i organogramit, puna do te ishte me efikase etj.

### Përvoja në shtetet tjera

Bazuar në rastin e Suedise, përkatësisht organizmit institucional Qendrës Kinematografike në Republikën e Suedise, marrë parasysh këtu dhe harmonizimin e legjisllacionit suedez karshi standardeve dhe praktikave evropiane të fushës, vlerësojmë se legjisllacioni

suedeze mbetet shembulli më i mirë dhe i përshtatshëm për rrethanat kosovare në kontekst të përditësimit të legjislacionit në fushën e Qendrës Kinematografike të Kosovës.

“Swedish Film Institute” funksionon si institucion ombrelle i kinematografisë në Suedi, i cili ka në menaxhim departamentet si në vijim: departamentin e subvencionimit të filmit “founding”, departamentin e promovimit, departamentin e ruajtjes së filmave Arkiva dhe Kinoteka ( Library, video library), dhe departamenti i Studios filmike. Pra shteti suedez ka Qendrën e filmit, e kryesuar nga Bordi i cili krijohet nga shteti. Bordi është i përbërë nga 7 anëtarë, i cili e emëron CEO (kryeshefin ekzekutiv të institutit) dhe secilin drejtor të departamentit përkatës.

Po ashtu edhe Danimarka e ka të rregulluar kinematografinë ngjashëm me Suedinë. Në Danimarkë ekziston “Danish film institute” i cili ka objektin e vet FILM HAUSE, pra qendrën apo shtëpinë e filmit, e cila është përgjegjëse për përkrahjen e filmit dhe për ruajtjen e filmit si interes kombëtar. Film house përbëhet nga departamente si Library, Kinoteka si muze i filmit kombëtar. Misioni i Institutit danez të filmit është promovimi i filmit danez kudo në bote, përkrahja e produksionit dhe zhvillimit të projekteve të të gjitha llojeve, distribuimi i filmit, arkivimin e filmave dhe aktivitetet e muzeut.

Republika e Maqedonisë para 4 viteve ka bere kalimin nga “Fondi i filmit” në Agjenci të filmit. Misioni i agjencionit të filmit në Maqedoni janë: subvencionon projekte filmike, mbështet kinematë, bene distribuimin e filmave, shfaqjen e filmave, zhvillimin e filmit dhe audiencave të reja, promovimin e filmave brenda dhe jashtë shtetit të Maqedonisë. Mirëpo Arkiva nuk është nën ombrellën e Agjencionit të filmit, pra është vetëm institut në kuadër të Ministrisë së Kulturës.

Kroacia është një tjetër shtet nga i cili mund të merret shembull. “Croatian audiovizuel centre” është Qendra Audiovizuale kroate, e cila promovon mbështetje tek të gjithë sektorët si: promovimi i filmit, financimin e filmave, dhe si sektor të veçante kanë lehtësirat financiare. Sikurse shteti maqedonas ashtu edhe shteti kroat Arkivin e filmit nuk e ka të inkuadruar si pjese e Qendrës audiovizuale të filmit. Pra Arkiva e filmit është Institut në vete në kuadër të Ministrisë së Kulturës.

Vlen të theksohet se QKK është në kontakt, ka zhvilluar takime të rëndësishme si dhe është duke përgatitur marrëveshje bilaterale me shtete të ndryshme të rajonit, e që padyshim të tilla marrëveshje janë të mirëseardhura për Qendrën Kinematografike të Kosovës.

### **Kapitulli 3: Synimet dhe objektivat**

#### **Synimi**

Përmes plotësim ndryshimit të ligjit aktual të Ligjit për Kinematografi, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit synon të krijojë dhe të zhvillojë politika, ambient dhe mekanizma të përshtatshëm për zhvillimin dhe promovimin e filmit duke stimuluar kështu krijimtarinë e Qendres Kinematografike të Kosovës.

#### **Objektivat**

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka për prioritet krijimin e një mjedisi mbështetës për zhvillimin bashkëkohor të film-berjes, si dhe promovimin e saj me vlera të mirëfillta dhe aftësi konkurruese në vend dhe në arenën ndërkombëtare.

Objektivat e synuara përmes plotësim/ndryshimit të ligjit aktual për Qendren Kinematografike e Kosovës janë me sa vijon:

1. Avancimi i kornizës ligjore për veprimtarinë institucionale të Qendres Kinematografike të Kosovës;
2. Ndryshim plotësimi i Ligjit për Kinematografi, futja e emërtimeve të ndryshme si dhe rregullimi normativ i formave të reja të zhvillimit kinematografik; rregullimi normativ i distribucionit të filmave;
3. Kalimi i QKK nga Instucioni në Agjenci, kalimi i kompetencave vendimmarrëse nga Ministria në QKK, funksionalizimi i Kodit buxhetor, si dhe funksionalizimi i Kosova Film-it, etj.

### **Kapitulli 4: Opsionet**

#### **Opsioni i 1. Status quo (asnjë ndryshim)**

Nëse nuk ndryshohet ligji aktual, vazhdon të mbetet situata që nuk reflektohen statusin juridik të Kosovës që pas shpalljes dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës dhe njëherazi nuk do të adresonte çështje të tilla si: lehtësirat financiare, problemet burokratike në

mes te institucioneve, organizimin dhe funksionalizimin efikas, problemet me subvencionimin e filmave, nevojën për te futur emërtime te reja dhe për ti rregulluar ato ligjërisht, etj.

### **Opsioni 2. Ndryshimi i politikës ekzistuese**

Ndryshimi i ligjit aktual do te sillte shume ndryshme pozitive për MKRS dhe Qendrën Kinematografike te Kosovës, duke bartur disa kompetenca te cilat ex officio i takojnë vetëm MKRS kundrejt QKK-ës, puna brenda QKK do te kryhej me lehte, do te ishte shume me efikase, burokracia aktuale nuk do te ekzistonte me. Pastaj me rregullimin normativ te disa çështjeve te cilat nuk janë parapare me herët me ligj apo rregullore e qe është e pashmangshme ndeshja me to ne punën tone te përditshme do ta lehtësonte punën tej mase. Pra ndryshim-plotësimi i ligjit aktual, do te ishte pozitiv për MKRS, QKK dhe mbare komunitetin.

### **Opsioni i 3. Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit**

1. Nëse ligji nuk plotësohet/ndryshohet dhe vazhdohet me zbatimin e politikës ekzistuese, nuk ka alternativ apo mënyrë tjetër për të rregulluar dhe adresuar çështjet identifikuar. Mënyra e ndryshuar e zbatimit të legjislacionit nuk ofron zgjidhje të problemit.
2. Për mos përmbushje të obligimit të marrë sigurisht se përgjegjës do të ishte fillimisht MKRS, por edhe Qeveria e Kosovës.
3. Trajnimet dhe programet tjera për qasjen ekzistuese të zbatimit nuk do të kanë efekt në adresimin e problemit. Adresimi i problemit bëhet vetëm me plotësim/ndryshimin e ligjit aktual.

### **Kapitulli 5: Analiza e opsioneve**

<b>Përmbledhja e Opsioneve</b>			
<b>Karakteristikat kryesore</b>	<b>Opsioni 1</b>	<b>Opsioni 2</b>	<b>Opsioni 3</b>
Karakteristikat kryesore të opsionit	Mos-normimi i emërtimeve te reja te film-bërjes ne ligjin për Kinematografi. Normimi për Kinematografi.	Ndryshim-plotësimi i Ligjit për Kinematografi, bartja e kompetencave nga MKRS ne	Ndryshimi ekzistues nuk do te mund te behej ndryshe, pos me ndryshim-plotësimin e ligjit

	lehtësirat financiare. Ndryshimi i rregullores për subvencionimin e filmave, përkatësisht harmonizimi me legjislacionin evropian.	QKK Harmonizim me plotësim-ndryshimin e Ligjit ne fuqi dhe Legjislacionin e BE-se.	aktual.
Segmenti i Popullsisë/sektori/rajoni i shënjestruar	MKRS, QKK, i gjithë komuniteti film-bërës, producentët, qytetarët, organizatat etj.	MKRS, QKK, Komuniteti.	
Administrimi ose zbatimi i programit ose i shërbimit	Ministria e Kulturës, Rinise dhe Sportit	-Ministria e Kulturës, Rinise dhe Sportit. - Qeveria e Republikës se Kosovës.	////
Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese si dhe zbatimi dhe dënimet	Ligji Nr. 2004/22 për Kinematografinë i aprovuar në Kuvendin e Kosovës në vitin 2004 sipas Komizës Kushtetuese për Institucionet e Përkohshme te Vetëqeverisjes në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/9).  Akte nënligjore: 1.Statuti i Qendrës Kinematografike te Kosovës; 2.Rregullore Nr. 02/2013 për subvencionimin e projekteve filmike nga Qendra Kinematografike e Kosovës;	Ligji Nr. 2004/22 për Kinematografinë i aprovuar në Kuvendin e Kosovës në vitin 2004 sipas Komizës Kushtetuese për Institucionet e Përkohshme te Vetëqeverisjes në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/9).	////

	<p>3.Rregullore Nr. 01/2013 për punën e jurisë vlerësuese për projektet filmike që subvencionohen nga Qendra Kinematografike e Kosovës;</p> <p>4.Rregullorja (MKRS) Nr.08/2016 për punën e jurisë vlerësuese për projektet filmike që subvencionohen nga Qendra Kinematografike e Kosovës;</p> <p>5.Rregullorja Nr. 04/2012 për ndarjen e çmimeve për kinematografi;</p> <p>6.Rregullore Nr. 13/2016 – MKRS për punën e Këshillit Drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës;</p> <p>7.Rregullore për organizimin funksionimin e Kosova Filmit.</p>		
Stimulimet ose mos-stimulimet ekonomike-subvencionet ose taksat	////	////	////
Fushatat e edukimit dhe komunikimit	Nuk është e nevojshme për fushate komunikimi.	Komunikimi për koncept dokumentin është bërë duke zbatuar Rregulloren Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Kosovës ku ka paraparë hartimin e Koncept Dokumentit	////

Afatet kohore –kur hyn në fuqi opsioni	Ligji Nr. 2004/22 për Kinematografinë i aprovuar në Kuvendin e Kosovës në vitin 2004 sipas Komizës Kushtetuese për Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/9).	për Kinematografinë. Pas miratimit dhe plotësimit ndryshimit Ligjit aktual nga Qeveria e Kosovës.
--	--	--

### Kapitulli 6. Përfitimet

Efekti shpërndarës

1. Plotësim/ndryshimit i ligjit aktual sjellë përfitime për institucionet qendrore, lokale, shoqërinë filmike, lokale, po ashtu ne punën me efikasitet të QKK.
2. Përfitimet dhe pasojat negative të elaboruara, lidhur me të gjitha opsionet e konsideruara nuk janë të lidhura me rajone apo pjesë të caktuara të Republikës së Kosovës, por ato kanë efekt të përgjithshëm në tërë territorin e vendit.
3. Ndikimet e opsioneve të konsideruara janë të njëjta për të gjithë komunitetin dhe veprojnë njëjtë në të gjithë, pra nuk ka efekte dalluese.

### Kosto

Për implementimin e këtyre opsioneve të propozuara nuk krijohen kosto shtesë buxhetore përveç atyre të parapara tashmë me Ligjin mbi Buxhetin për vitin 2018. Vazhdimi i aplikimit të politikave aktuale dhe ndryshimi i politikave aktuale nuk paraqet ndryshime në shpenzimet buxhetore.



Për më tepër, asnjëri nga opsionet e hartuara nuk paraqet diferencë në gjenerimin e të hyrave dhe në alokimin e shpenzimeve.

## **Kapitulli 7: Konsultimi**

Konsultimi me ekspertë, institucionet kulturore, shoqatat filmike, producent, komunitet etj.

Si përfundime kanë qenë që ligji aktual duhet të ndryshohet bazuar në praktikat e vendeve të tjera dhe marrjen e praktikave të mira sidomos nga shtetet si Sllovenia dhe Kroacia e që kanë krijuar institucione të qëndrueshme të Qendres Kinematografike të Kosovës.

Konsultimi me publikun dhe shoqërinë civile:

- Konsultimet kryesisht janë bërë në takimet tona me akterët kryesor të shoqërisë civile dhe shoqatave të fushës filmike dhe botes kinematografike në përgjithësi.

## **Kapitulli i 8: Krahasimi i opsioneve (vlerësimi i pasojave të secilit opsion)**

Opsioni i parë është opsion i cili shtjellon gjendjen aktuale kinematografike në Kosovë, ligjin dhe rregulloret e aplikueshme, i cili ka shume mangësi dhe te meta.

Opsioni i dytë është plotësim/ndryshimi i ligjit aktual e që do të ishte opsioni më i qëlluar dhe i rekomanduar për arritjen e synimit dhe objektivave të parapara si në çështjen kryesore të shqyrtuar në këtë draft-koncept dokument.

Opsioni i tretë është opsioni i cili pa ndryshim-plotësimin e Ligjit për Kinematografi do të na kthente në gjendjen aktuale.

## **Kapitulli 9: Rekomandimi**

Rekomandohet:

1. Gjatë rishikimit të kornizës ligjore të kihet parasysh harmonizimi me Kushtetutën e Kosovës, ligjet në fuqi dhe praktiken Evropiane dhe nderkombetare, pra harmonizimi me legjislacionin e BE.
2. Procedurat për plotësimin dhe ndryshimin do të kryesohen nga ana e Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, në bashkëpunim me institucionet dhe grupet e interesit që të arrihen objektivat e parapara.
3. Brenda tremujorit të parë që nga aprovimi i Koncept Dokumentit në Qeveri duhet të fillojë plotësimi /ndryshimi i ligjit aktual.
4. Nuk do të ketë ndryshime të mëdha në kosto plotësim ndryshimin e ligjit aktual.
5. Nga momenti i aprovimit të koncept dokumentit do të formohet ekipi punues për plotësim/ndryshimin e ligjit, i cili do të përcjell informatat e përditësuara lidhur me procesin e hartimit të koncept-dokumentit në fjalë.

## **Kapitulli 10: Komunikimi**

1. Akterët kryesorë të fushës janë në dijeni për fillimin e procedurave lidhur me ndryshimin e ligjit aktual. Ata do të jenë të njoftuar për çdo veprim të ri përmes shkresave zyrtare dhe e-mailave.
2. Me akterët e prekur do të komunikohet bazuar në procedurat e parapara me akte ligjore dhe nën-ligjore, varësisht nga faza e zhvillimit të procedurës.
3. Konsultimet do të realizohen për secilën fazë të procesit, duke filluar nga momenti i aprovimit të koncept dokumentit.

## **11. Projekt vendimi i Qeverisë**

1. Aprovohet Koncept-Dokumenti i për Qendren Kinematografike e Kosovës.
2. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim më Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.